




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.55/2024

Datë: 22 shkurt 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 7 të Ligjit Nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 25 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 26.07.2023, në takim e 321-të, të mbajtur me datë 22 shkurt 2024 merr këtë:

#### V E N D I M

- I. Caktohet Grupi Punues për hartimin e Planit të Integritetit, në përputhje me përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, me përbërjen si në vijim:
  1. Fahret Vellija, anëtar i KGJK-së;
  2. Bislam Gashi, udhëheqës i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në SKGJK;
  3. Rudin Elezi, administrator i Gjykatës Themelore në Gjakovë.
- II. Obligohet Grupi Punues të përgatisë një program për hartimin e Planit të Integritetit, përmes së cilit do të informojë punonjësit për qëllimin, rëndësinë dhe mënyrën e hartimit të Planit të Integritetit, do të vlerësojë gjendjen aktuale të funksionimit të institucionit dhe do të analizojë masat ekzistuese për menaxhimin e rrezikut të korrupsionit, do të vlerësojë intensitetin e rrezikut të korrupsionit, do të propozojë afate dhe persona përgjegjës për zbatimin e masave përmirësuese që ulin rrezikun e korrupsionit, si dhe do të informojnë punonjësit për situatën në institucion duke vlerësuar intensitetin e rrezikut të korrupsionit dhe planin e zbatimit të masave përmirësuese. Grupi Punues mund të përfshijë punonjës të tjerë të institucionit në hartimin e Planit të Integritetit.
- III. Grupi i Punës përfundon hartimin e Planit të Integritetit jo më vonë se me datën 25 mars 2024.
- IV. Përgjegjës për miratimin e Planit të Integritetit është Këshilli Gjyqësor i Kosovës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me datë 22 shkurt 2024.

## Arsyetim

Ky vendim nxirret me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr.19, datë 21.07.2022), në raport me detyrimet e Institucioneve të Pavarura për miratimin e Planit të Integritetit.

Prandaj duke marrë parasysh rëndësinë dhe qëllimin e hartimit dhe miratimit të Planit të Integritetit, si një dokument i cili paraqet rezultatin e vetëvlerësimit të ekspozimit të institucionit ndaj korrupsionit dhe formave tjera të cënimit të integritetit, qëllimi i të cilit është të ruajë dhe përmirësojë integritetin e institucionit duke thjeshtuar procedurat, duke forcuar llogaridhënien, kontrollin e kompetencat diskrecionale, edukimin, forcimin e etikës, krijimin e një sistemi efektiv kontrollin dhe eliminimin e praktikave joefikase.

Grupi Punues si në pikën 1 të dispozitivit të këtij Vendimi, është përgjegjës që gjatë punës së tij të ketë parasysh të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara si në pikën 2 të dispozitivit, si dhe të veprojë sipas udhëzimeve dhe procedurave standarde të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit. Kjo me qëllim të krijimit të një mekanizmi institucional, i cili do të kontribuojë në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të funksionimit të institucionit.

Nga ajo çfarë u theksua në arsyetim, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert Zogaj

Kryesues i Këshillit Kryqësor të Kosovës



*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- Anëtarëve të grupit punues;
- Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit;
- Sekretariatit të KGJK-së;
- Arkivit